

THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

Qendra ALERT, në kuadër të zbatimit të projektit “ALERT për mbrojtjen e konsumatorit”, të mundësuar nga Programi SustainMedia, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Gjermane, shpall thirrjen e interesit për ndërtimin dhe realizimin e një aplikacioni për mobile dhe tablet, sipas kërkesave dhe me të dhënat e mëposhtme:

Aplikacioni duhet të jetë i vlefshëm për IOS dhe Android

Të mbartë të gjithë informacionin që gjenden në web-in Alert.al

Të dërgojë njoftime/lajme në kohë reale në pajisjet e të gjithë personave që e kanë shkarkuar për çdo material që do të publikohet

Të jetë në tri gjuhë; shqip, anglisht dhe gjermanisht

Të jetë i paisur me modulën e Scan QR, me qëllim përdorimin dhe skanimin e QR-ve të të gjitha produkteve nga konsumatorët

Të përmbajë kontaktet e institucioneve publike që kanë lidhje me mbrojtjen e konsumatorit

Të përmbajë numrat e emergjencave

Të ketë në brendësinë e tij njoftimet më të fundit për riskun ndaj konsumatorit

T’ju ofrojë mundësinë konsumatorëve, që të denoncojnë/ankohen në kohë reale duke ngarkuar në aplikacion tekst, foto, video etj, të lidhura këto autoatikisht me e-mailin dhe numrat e telefonit të Qendrës ALERT.

Të jetë i kompletuar me të gjithë bazën ligjore për mbrojtjen e konsumatorit

Kërkesat të tjera që duhet të përmbushë aplikacioni:

Ndërtim modular, i cili të lejojë shtimin apo përmirësimin e funksionaliteteve në mënyrë të shpejtë dhe efikase

Mundësi për të menaxhuar strukturën e lundrimit në faqe

Mundësi për të menaxhuar nënshkruarit në Newsletter

Të ofrojë module për auditimin e sigurisë së platformës

T’u ofrojë mundësinë zhvilluesve për të ndërtuar dhe integruar module të personalizuar

Të ndërrohet password i përdoruesit “Admin”, i cili jepet by-default nga ofruesi

Të përdoren password-e komplekse

Të përdoret password protect folders në control panel, në rast se është e nevojshme

Të mos shfaqen informacione sensitive lidhur me mesazhin “Error”, i cili del në rastet kur aplikacioni mund të ketë probleme

Në rastet kur kemi një fushë në të cilën bëjmë File Upload, duhet të aplikohen kufizime në mënyrë që përdoruesit të mos uploadojnë skripte jo legjitime, vetëm file si jpg, Pdf, docx etj;

Siguria

Siguria kibernetike është një element i rëndësishëm i faqeje web apo aplikacioni. Kontraktori duhet të ndjekë standardet dhe praktikat më të mira në fushën e sigurisë së sistemeve informative.

Shërbime të konsulencës

Asistencë për stafin teknik të institucioneve në analizën e të dhënave, përdoruesve

Asistencë teknike për problemet e lidhura me komunikimin me sisteme apo komponentë të infrastrukturës

Kërkesa teknike, mirëmbajtja

Kontraktuesi duhet të ofrojë suport dhe mirëmbajtje për sistemin për një periudhë 12 mujore nga data e nënshkrimit të kontratës. Gjatë kësaj periudhe, detyra e kontraktorit është të sigurojë mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike për aplikacionin, duke garantuar gatishmërinë on-line, sikurse të zhvillojë dhe implementojë zgjidhje teknologjike që përmirësojnë eksperiencën e përdoruesve dhe aftësinë e portalit për t'iu përgjigjur nevojave të audiencës.

Në përgjithësi pritet që kontraktori të:

Sigurojë mbështetje për gjetjen dhe rregullimin e gabimeve dhe mirëmbajtjen e aplikacionit të Qendrës ALERT, të bashkëpunojë me personat përkatës për përditësimin e informacioneve dhe materialeve sikurse të jetë pjesëmarrës aktiv në gjetjen e problemeve dhe implementimin e zgjidhjeve

Të ofrojë ide dhe rekomandime për të zhvillimin e vazhdueshëm të funksionaliteteve të aplikacionit

Të ofrojë ekspertizë teknike dhe kreative për të krijuar, menaxhuar dhe përditësuar informacionet dhe materialet e prezantuara në app.

Mirëmbajtje teknike periodike

Përmirësim i vazhdueshëm për të siguruar përmirësimin e ndërfaqes së përdoruesit në pajisje të ndryshme

Mirëmbajtje dhe përmirësimin i funksionaliteteve të aplikacionit. Pasurimi i tij, sipas kërkesave të kontraktuesit

Menaxhimi, përditësimi dhe përmirësimi i navigimit dhe arkitekturës së informacionit

Menaxhimi i design-it; përmirësimi i paraqitjes së App mbi baza periodike

Kriterët për kualifikimin e ofruesve të shërbimit

Ofruesit të shërbimit i kërkohet të ketë:

Të paktën 3 vjet përvojë pune në realizimin dhe mirëmbajtjen e produkteve të tilla

Kapacitete dhe infrastrukturë teknike për të siguruar prodhim me cilësi të lartë

Afati kohor i realizimit të aplikacionit

Dorëzimi i produktit përfundimtar do të jetë 15 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës.

Pronësia intelektuale

Të gjitha informacionet në lidhje me këtë produkt do të mbeten pronë e Qendrës ALERT, e cila do të ketë të drejta ekskluzive mbi përdorimin e tij.

Detyrimet kontraktuale

Shërbimi do të kontraktohet sipas kushteve të kontratës së Qendrës ALERT dhe do të mbikëqyret po nga ALERT, për të ofruar rezultatet e mësipërme brenda kornizës kohore të rënë dakord.

Ofruesi i shërbimit duhet të marrë miratimin paraprak nga Qendra ALERT për produktin e kërkuar.

Procedura e Aplikimit

Aplikantëve u kërkohet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme në e-mailin info@alert.al jo më vonë se data 12 Gusht 2023, ora 17.00.

Dokumentacioni i kërkuar nga aplikantët:

CV personale të personit teknik të propozuar për këtë projekt duke theksuar kualifikimet dhe përvojën në projekte të ngjashme;

Një portofol me 3 punime të ngjashme;

Propozimi financiar për kryerjen e shërbimit/produktit;

Kontaktet (telefon dhe adresë);

Tiranë, më 03.08.2023